



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 47/16

Prishtinë, më 07.03.2016, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – Zëvendës-ministër i Financave, Ismet Krasniqi-Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu-Drejtori i Administratës në Kuvendin e Kosovës dhe Istret Azemi-Drejtor i Buxhetit të Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Lumnije Murati – nga Zyra e Presidentit, përfaqësues nga KDI, OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18.02.2016 dhe 19.02.2016;
3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Klllokotit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015;
6. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Kryetari konstatoi se Komisioni njëllojë miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 18.02.2016, 19.02.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Klllokotit për vitin 2016

Kryetari – sqaroi se në bazë të nenit 62.4. të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nëse kuvendi komunal i ndonjë komune, miraton buxhetin e saj pas miratimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës nga ana e Kuvendit të Kosovës, atëherë i dorëzon Ministrin të Financave propozim-buxhetin komunal dhe kërkesën për ndarje buxhetore. Ministri duhet që menjëherë t’ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila i’a dorëzon këto dokumente Kuvendit. Kuvendi mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që ta ndryshojë Buxhetin e Republikës së Kosovës, për t’i pasqyruar dokumentet e dorëzuara. Komuna e Klllokotit, e ka ri-aprovuar buxhetin më datë 29.01.2016, dhe e ka dërguar në Ministrinë e Financave, e cila përmes qeverisë e ka dërguar në Kuvend.

Agim Krasniqi – theksoi se Komuna e klllokotit në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me datën 29.1.2016 e ka riaprovu buxhetin, dhe e ka proceduar në ministrin e financave dhe përmes qeverisë është dërguar në Kuvend. Buxheti i riaprovuar i komunës së klllokotit është në përputhje me qarkoret buxhetore të ministrisë së financave, e sipas vendimit buxheti total i kësaj komune është 850,699 euro.

Kryetari – keni parasysh se buxheti i riaprovuar i komunës së klllokotit është për më shumë se 55 mijë euro më i lartë, krahasur me buxhetin e miratuar aktualisht për këtë komunë, dhe këto mjete janë planifikuar nga të hyrat vetanake.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

Buxheti i Komunës së Klllokotit për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Klllokotit, me datë 29.01.2016, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

4. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari – sqaroi se në bazë të paragrafit 4 të nenit 101 të Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të republikës së kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-092, Qeveria i propozon Kuvendit, shkarkimin e kryetarit apo një anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, nëse ai/ajo vepron në kundërshtim me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrat e tij/saj. Mbështetur në këtë bazë ligjore, Qeveria i ka prozuar Kuvendit shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të OSHP-së, për shkak se ndaj të njëjtit është ngritur aktakuzë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, është arrestuar dhe gjindet në paraburim për veprat penale, që bien në ndesh me etikën profesionale që ndërlidhen me detyrat e tij, e që sipas ligjit të prokurimit publik është bazë e mjaftueshme për propozimin nga Qeveria dhe shkarkimin e anëtarit në fjalë nga Kuvendi. Ne e kemi ndryshuar ligjin e prokurimit në seancën e kaluar dhe është paraparë edhe kjo mundësi ku qeveria propozon dhe Kuvendi shkarkon anëtarin apo kryetarin e OSHP-së. Por kjo nuk paragjykon zhvillim dhe përfundimin e procesit gjyqësor ndaj anëtarit në fjalë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkarkimin e z. Bajram Zogiani, nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
2. Propozim-Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkarkimin e z. Bajram Zogiani, nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të radhitet për shqyrtim në Seancën Plenare, të datës 10.03.2016.

5. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015

Kryetari – në bazë të të dhënave të prezantuara në raportin e shpenzimeve për vitin 2015, shofim se realizimi i buxhetit të Kuvendit është i mirë në të gjithë kategoritë ekonomike, përfshirë edhe investimet kapitale.

Ismet Krasniqi – theksoi se në vitin 2015, Kuvendi ke realizuar buxhetin në total prej 95.10%. Sipas kategorive ekonomike, buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje është 100%, për mallra dhe shërbime, 73.32%, shpenzimet komunale janë realizuar 99.98%, subvencionet dhe transferet 100%, ndërsa shpenzimet komunale dhe investimet kapitale janë realizuar 99.98%.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2015.

6. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetari – theksoi se në draft-planin e punës të komisionit për vitin 2016 janë përfshirë të gjitha aktivitetet që komisioni i ka paraparë të realizohen gjatë këtij viti. Siç janë shqyrtimi i projektligjeve dhe amendamenteve të komisioneve funksionale në aspektin e ndikimit buxhetor, shqyrtimi i raportit të qeverisë për Buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2015. Komisioni, po ashtu do të shqyrtoj Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019. Në këtë proces do të aplikoj edhe me tutje sistemin e raportimit, siç e kemi planifikuar në mbështetjen e GIZ. Po ashtu, Komisioni do të shqyrtojë raportet vjetore dhe financiare të institucioneve apo agjensioneve të pavarura. Ajo që është e rëndësishme për neve të vazhdojmë më tutje me raportimin e insitucioneve që krijojnë të hyra buxhetore, të Administratës Tatimore edhe të Doganave së Kosovës. Po ashtu do të vazhdojmë me monitorimin e ligjeve. Në kuadër të kësaj ne e kemi një ligj në procedurë të monitorimit, që është ligji për akcizën në produktet e duhanit. Përveç këtij ligji, unë ka propozuar të monitorojmë edhe Ligjin për partneritetin publiko-privat.

Safete Hadergjona – ne mund të monitorojmë Ligjin për partneritet publiko-privat, dhe të shikojmë se a është pengesë ligji që nuk ka pas veprimtari më të dukshme në këtë drejtim apo është problemi diku tjetër.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

Komisioni miratojë Planin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016.

7. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit se Komisioni funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, e ka miratuar ne parim Projektligjin për Falimentimin dhe ka formuar grupin e punës. Komisioni një fjalë ka ftuar një apo dy anëtar të Komisionit për buxhet dhe financa të bashkohen këtij grupi të punës, sepse ky projektligj bie edhe në domenin financiar të kompanive si dhe insolvensen e tyre.

Në bazë të deklarimit vullnetar, Komisioni caktojë znj. Safete Hadergjonaj, si përfaqësuese të Komisionit për Buxhet dhe Financa në grupin punues të themeluar nga Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, për shqyrtimin e Projektligjit për Falimentimin.

Mbledhja përfundoi në ora 13:50

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani